

BASHKIA ELBASAN
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

1. Autoriteti dhënies në përdorim: Bashkia Elbasan, adresa: Rr. “Qemal Stafa”, nr.tel/fax:(+355)54 400152, e-mail : bashkiaelbasan@elbasani.gov.al.

2. Të dhënat për sipërfaqen: Sipërfaqja e fondit pyjor prej 4.1 ha, të ndarë në lote:

- Loti i parë: Për sasinë totale prej 1 (një) ha në n/ngastrën pyjore nr.73/a, ekonomia pyjore “Polis-Vasjan ”.
- Loti i dytë: Për sasinë totale prej 2,6 (Dy presje gjashtë) ha në n/ngastrën pyjore nr.24/b ekonomia pyjore “Fushëkuqe-Zavalinë”.
- Loti i tretë: Per sasine totale prej 0,5(zero presje pesë)ha në n/ngastrën pyjore nr.10/a në ekonominë pyjore “Labinot”.

3. Qëllimi i dhënies në përdorim:

- Loti i parë:..Agropylltari.
- Loti i dytë:Për qëllime argëtimi,shëndetësore,shoqërore dhe veprimtari turistike,kampingje.
- Loti i tretë:Për qëllime argëtimi,shëndetësore,shoqërore dhe veprimtari turistike,kampingje.

4. Afati i dhënies në përdorim: është 10 (dhjetë) vjet, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

5. Vlera dysheme për detyrimin e përdorimit e ndarë në lote:

- Loti i parë: 10,000 (dhjetë mijë) Lekë/vit, pa T.V.SH.
- Loti i dytë: 286,000 (dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë) Lekë/vit, pa T.V.SH.
- Loti i tretë: 41,250 (dyzet e një mijë e dyqind e pesëdhjetë) Lekë/vit, pa T.V.SH

6. Vendi i Zhvillimit të Konkurrimit: Konkurrimi për marrjen në përdorim do të kryhet në ambjentet e zyra të Bashkisë Elbasan, Drejtoria e Pyjeve dhe Bujqesise (kati i trete). Dokumentat standard të konkurimit tërhiqen në adresën e sipërcituar.

7. Vleresimi i ofertave konkurrese do të bëhet me pikë si vijon:

- projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10 000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit 20 pikë;
- planbiznesi dhe investimet që do të bëhen 15 pikë;
- planin e rehabilitimit të sipërfaqes 25 pikë;
- nivelin e punësimit në veprimtari 5 pikë;
- masën e qirasë për ha/vit 35 pikë

8. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim janë:

- a) formularin e sigurimit të ofertës për shumën dhe vlefshmërinë e kërkuar, për secilin lot më vehte, në dokumentet standarde të konkurimit.
- b) ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë.
- c) certifikatën e regjistrimit në organin tatimor ose NIPT-in.
- d) në rastin e personave fizik dokumenti origjinal i identifikimit një kopje e të cilit depozitohet pranë komisionit të vlerësimit të ofertave.
- e) vërtetim nga prokuroria, gjykata, Drejtoria Rajonale Tatimore, Taksat Vendore.
- f) garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimit të parashikuar në plan-biznes.
- g) të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV_në profesionale të tregohet provoja në fushën e veprimtarisë.

9. Dokumentacioni i nevojshëm:

- a. Kërkesën e subjektit për marrjen me qira të pasurisë shtetërore, së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
- b. Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;
- c. Planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
- d. Të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- e. Planin e rehabilitimit të sipërfaqes nëse është i zbatueshëm;
- f. Nivelin e punësimit në veprimtari;
- g. Çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
- h. Adresën e subjektit, telefon, e-mail dhe faks;

10. Dokumentacioni duhet të paraqitet në zarf të mbyllur, të nënshkruar nga konkurruesi me mbishkrimin “Ofertë për dhënie përdorim”, dhe i dorëzohet komisionit të posaçëm për vlerësimin e dokumentacionit, në orën e hapjes së procedurës së konkurimit.

Mosparaqitja e njërës prej dokumenteve të mësipërme ose paraqitja e dokumentave të rremë, përbën kusht skualifikues.

Ofertat dorëzohen nga konkurrenti/ët e interesuar, fizikisht me postë ose dorazi në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurrencës.

Data e zhvillimit të konkurrencës: 09.06.2026, ora 09:30 (Loti I) 10:00 (loti II) 10:30(Loti III) , në ambientet e zyrave të Bashkisë Elbasan, Drejtoria e Pyjeve dhe Bujqësisë (kati i tretë).

Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: date 09.06.2026, ora 09:30(Loti I) 10:00(loti II) 10:30(Loti III)